

VENDIM
Nr. 659, datë 2.9.2026

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 328, DATË 29.5.2024,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRANSFERIMIN TE KORPORATA E
INVESTIMEVE SHQIPTARE TË PRONAVE SHTETËRORE, NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE, PËR REALIZIMIN
E PROJEKTIT TË INVESTIMIT ‘PËR ZHVILLIMIN DHE MENAXHIMIN E
PRONAVE SHTETËRORE’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 71/2019, “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, dhe në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 1, të kreut II, të vendimit nr. 137, datë 6.3.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurës për dhënien e pronës shtetërore me qira, enfitëozë, *leasing*, shitje, përdorim si kolateral dhe të përdorimit në formë të tjera nga ana e Korporatës së Investimeve Shqiptare”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 328, datë 29.5.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e projektit të investimit ‘Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore’”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur vendimit, shtohen pasuritë e listuara në shtojcën nr. 1.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- b) Në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur vendimit, shtohen pasuritë e listuara në shtojcën nr. 2.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- c) Shtojca nr. 3, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me shtojcën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare, Qendra e Botimeve për Diasporën, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Avokatura e Shtetit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para, Akademia e Energjisë, Albgaz sh.a., Enti Rregullator i Energjisë, që, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të lidhin marrëveshje bashkëpunimi për përcaktimin e standardit, metodologjisë, termave dhe kushteve të bashkëpunimit për përmbushjen e interesit publik, autoritetit në përgjegjësi administrimi të të cilit regjistrohet prona e re shtetërore, që zhvillohet si rezultat i përmbushjes së kushtit të transferimit të pronës/autorizimit për zhvillim, në të cilin përcaktohen edhe kushtet e nevojat për dorëzimin e pronës, si dhe sigurimin e ambienteve të përkohshme për vazhdimin e aktiviteteve të institucioneve publike që përdorin/administrojnë këto prona, në rastet kur institucionet, për nevoja të zhvillimit të projektit të investimit, janë të detyruara të lirojnë këto prona.

3. Autorizohet Korporata e Investimeve Shqiptare dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit të ndryshojnë marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit, me qëllim mbulimin nga Korporata, nëpërmjet projektit të investimit “Copëzat”, të punimeve për përshtatjen e ambienteve të punës në pronën në përgjegjësi administrimi të këtij institucioni, sipas projektit arkitekturor dhe preventivit të përgatitur prej saj.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Qendra e Botimeve për Diasporën, Agjencia për Mbështetjen

e Shoqërisë Civile, Avokatura e Shtetit, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para, Akademia e Energjisë, Albgaz sh.a., Enti Rregullator i Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Korporata e Investimeve Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA NR. 1.1

PRONAT QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË KORPORATËS

Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
8150	6/232	294.5			Shtet
8150	6/233	251.9			Shtet

SHTOJCA NR. 2.1

PRONAT ME FUNKSION VETËM PUBLIK, PËR TË CILAT KORPORATA VEPRON SI ZHVILLUES

Zona kadastrale	Nr. pasurisë	Sip. e pasurisë (m ²)	Nga sip.		Institucioni me pronësi/përgjegjësi administrimi
			Truall (m ²)	Ndërtesë (m ²)	
8270	6/458	60	60		Shtet
8270	6/100	15	15		Shtet
8270	6/461	23.45	23.45		Shtet
8270	6/480	45.5	45.5		Shtet
8270	6/671	170			Shtet
8310	7/526	3913	3913	1082	Ministria e Financave, VKM-ja nr. 535, datë 4.8.2006, e ndryshuar
8270	7/79	876	876	468	Shtet
8270	2/233	3803	3803	767.8	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve VKM-ja nr. 818, datë 6.12.2006, e ndryshuar
8250	3/42-N1	757.67		757.67	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve VKM-ja nr. 818, datë 6.12.2006, e ndryshuar

INSTITUCIONET PUBLIKE TË CILAT LIDHIN MARRËVESHJEN E
BASHKËPUNIMIT ME KORPORATËN E INVESTIMEVE SHQIPTARE

Kuvendi i Shqipërisë, Agjencia për Media dhe Informim, Komiteti i Pakicave Kombëtare, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve, Autoriteti Kombëtar i Investigimit për Sigurinë e Operimit në Aviacionin Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, Agjencia e Auditimit të Programeve së Asistencës Akredituar nga Bashkimi Evropian, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Agjencia e Zhvillimit të Territorit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Rajonale e Mjedisit Tiranë, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, Agjencia Kombëtare e Turizmit, Qendra e Botimeve për Diasporën, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Avokatura e Shtetit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Trajtimit të Pronave, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Agjencia për Eficiencën e Energjisë, Qendra Rajonale e Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para, Akademia e Energjisë, Albgaz sh.a., Enti Rregullator i Energjisë sh.a., entitetet dhe institucionet e përcaktuara nga ministritë e linjës, si dhe çdo entitet publik, përfitues sipas kërkesës së tyre, brenda mundësive funksionale të objekteve publike dhe përcaktimit në marrëveshjet përkatëse.